



REPUBLIKA E KOSOVËS		KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUČITRN
01 Nr. / Br.	121 / 16	
Nr. i fq. / Br. st	- 16 -	
Data: / Datum	30. 06. 2016	
VUSHTRRI - VUČITRN		



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

**PROCES VERAL  
NGA MBLEDHJA E V-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR  
MË 25 MAJ 2016**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muhamrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

**Mungoi:** Habibe Gërxhaliu.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –duke prezantuar rendin e ditës, arsyetoj para anëtarëve të kuvendit se zhvendosja e datës së mbajtjes së seancës së kuvendit për një datë më herët është bërë për shkak të obligimit për rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2016 i cili është bërë konform instruksionit të dhënë nga Ministria e Financave ku deri me datën 25.05.2016 është afati përfundimtar që të dërgohet vendimi për rishikimin e buxhetit të komunës në ministrin përkatës. Gjithashtu në kuadër të pikës në të ndryshme ai propozoi edhe dy pika shtesë të futen në rend të ditës.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit**- tha se në thirrjen për seancën e rregullt për datën 26/05/2016 me rendin e ditës të cilin e kemi marr me materiale të zakonshme dhe me pas edhe një njoftim me email dhe thirrje telefonike, duke e dite se në baze të rregullores së punës të këtij kuvendi mbledhja e rregullt është e caktuar të mbahet të enjten e fundit te muajit.

Dëshiron të dije se mbledhja e sotshme a është mbledhje e rregullt apo mbledhje e jashtëzakonshme.

Duke u bazuar ne statutin e komunës, përkatësisht nenin 45 dhe 46 të cilët e rregullojnë thirrjen e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme si dhe duke u bazuar edhe në rregulloren e punës së kuvendit komunal në nenet 6,7,8 dhe 9, e ajo që asaj po intereson është se a jemi sot ne mbledhje të rregullt apo të jashtëzakonshme.

Nëse është urgjente çështja e shqyrtimit te rishikimit te buxhetit atëherë konsideroj se është dashtë që sot kjo të quhet mbledhje e jashtëzakonshme e kuvendit.

Dhe atë nëse thirrjen tuaj që për çudi e quani me termin “njoftim” është dashur të thirreni në nenin 46.8 të statutit ku thuhet “Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për mbledhjet që thirren për shkak të rrëthanave urgjente” pastaj në nenin 9.4 të rregullores së Kuvendit te Komunës ku thuhet “Procedurat e cekura ne paragrafin paraprak nuk zbatohen për mbledhjet që

thirren për shkak të rrethanave urgjente, që nënkupton ftesën përmes telefonit” dhe nuk ka mundësi që të dyja seancat të bashkohen pa respektuar statutin dhe rregulloren.

Mandej ajo vlerësoi se delegatet nuk duhet të privohen nga e drejta për te diskutuar edhe çështje të tjera gjithmonë duke u bazuar ne rregulloren e punës së kuvendit në nenin 9.2 ku thuhet se “e drejta për të thirrur mbledhje të jashtëzakonshme përfshin të drejtën për të caktuar rendin e ditës për mbledhjen e caktuar, në këtë rast rendi i ditës nuk mund te ndryshohet”.

Ajo më tej ceku se nuk është kundër që kjo seancë të mbahet ashtu qysh është propozuar por është kundre shkeljeve të dispozitave ligjore dhe dyshon që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do ti kthejë mbrapa të gjitha vendimet e marra në këtë seancën.

Në fund ajo kërkoj nga koleget jurist që ta japid një vlerësim lidhur me atë se si duhet të quhet kjo seancën dhe a kemi të drejt që rendin e ditës të paraparë për mbledhjen e rregullt ta bashkojmë me rendin e ditës të një mbledhje të jashtëzakonshme?

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha se mbledhjet e kuvendit në bazë të ligjit, mbahen të enjten e fundit të muajit por për arsyte urgjente është ndërruar data e kësaj mbledhje si dhe me qëllim të mbajtjes vete të një mbledhje dhe kursimit të buxhetit të komunës, andaj lidhur me ato që tha anëtarja e kuvendit është e drejtë e saj që ti adresohet mistrisë gjegjëse për të gjitha dilemat dhe paqartësitë eventuale.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** –tha se për ndërrimin e datës së mbledhjes së kuvendit u njoftuan për mesë telefonit por ishte i çuditshëm faktin se numri prej të cililit jemi thirrur ishte i panjohur dhe kjo formë e njoftimit nuk është korrekte. Tutje shtoi se procesi i rishikimit të buxhetit të komunës është fakt që dihet i cili ndodhë rëndom në pas gjysmës së parë të vitit kalendarik andaj nuk është dashur të pritet data e fundit por është dashur që përgatitjet të bëhen me kohë. Pastaj duke ju referuar nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale paraqiti vërejtje lidhur me atë se propozim-vendimi për rishikimin e buxhetit nuk ka kaluar në shqyrtim në Komitetin për Politikë dhe Financa e që është obligim ligjor dhe për këtë është dashur që administrata kommunale të bëjë përgatitjet me kohë.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit-në** emër të Grupit të Grave Kuvendare propozoi që në pikën në të ndryshme të futet në rend të ditës kërkesa për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Amra Brahimin.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-në** emër të Grupit Kuvendar të LDK-së paraqiti disa vërejtje lidhur me rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2016 dhe atë si në vijim: në nenin 18 të Rregullores së Punës së Kuvendit thuhet se para se të paraqiten në kuvend, çështjet duhet të shqyrtohen nga kryetari i kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa. Pastaj duke marrë për bazë rendësin e rishikimit të buxhetit në materialin e ofruar thuhet se materiali ka arritur në komunë me datën 16.05.2016 kurse mbledhja e komitetit është mbajtur me datën 17.05.2016 që i bie se një ditë më herët se mbajta e mbledhjes së KPF-së ky material ka arritur në komunë. Mandej na thuhet se afati i fundit për dorëzimin e rishikimit të buxhetit në ministrin gjegjëse është data 25.05.2016 kurse ky afat në të vërtet është deri me 02.06.2016. Kurse lidhur me pajisjen e anëtarëve të kuvendit me këtë material është bërë përmes adresës elektronike por edhe në këtë mënyrë disa anëtar të KK-së nuk e kanë pranuar këtë material. Në vazhdim vlerësoi se rishikimi i buxhetit në projekte të ndryshme i bërë me kaq shpejtësi dhe pa u analizuar nuk është me vend dhe për këtë është dashur që shefat e grupeve kuvendare të takoheshin dhe të shikohen mundësit më të mira për rishikimin e këtyre mjeteve financiare. Në fund tha se takimi i përfaqësuesve të partive në kuvend do të ishte modalitetit më mirë për kalimin dhe procedimin e këtij dokumenti në kuvend por kjo formë e procedimit bart me vete shumë shkelje procedurale dhe shtoj se për kundër këtyre për shkak të urgjencës së çështjes ata nuk do të votojnë kundër.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-tha se pasi që dokumenti për rishikimin e buxhetit për vitin 2016 ka ardhur me mjaft urgjencë ai kishte telefonuar Kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Naim Ismajlin ku i kishte kërkuar sqarime se përse me kaq urgjencë është ofruar në komunë dokumenti për rishikimin e buxhetit kur akoma nuk ka kaluar gjatë

mujori i parë i vtitit dhe i kishte kërkuar atij që mundësish kufizat e afat të shqyrtimit. Të shto se pas kësaj eshtë konsultuar me kryesuesin e kuvendit se si të veprohet në këtë rast dhe kishte pas ide që të mbahet seancë e jashtëzakonshme për datën 25.05.2016 kur edhe ishte afati i fundit për dorëzimin e vendimit për rishikimin e buxhetit. Mandje kryesuesi i kuvendit ka dhënë propozimin me të cilin ishte pajtuar që kjo pikë të shqyrtohen një ditë më herët se sa data e paraparë për mbajtjen e mbledhjes së kuvendit. Pastaj lidhur me mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme nuk ka pasur probleme nëse ajo do të ishte mbajtur sepse ajo eshtë edhe ligjërisht e paraparë që të mbahet dhe për këtë nuk ka as pengesa buxhetore. Në fund tha se pika për rishikimin e buxhetit eshtë bashkuar me pikat tjera për këtë mbledhje dhe tanë mbetet në vlerësimin e anëtarëve të kuvendit se si do të votojnë këtë rend dite.

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP**-propozoi një pikë shtesë për ta futur në rend të ditës në pikën në të ndryshme propozim-vendim për ndërtimin e një çeshmje publike.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** –e përkrahi propozim-vendimin për ndërtimin e çashmes publike nga një donator turk dhe apeloi tek anëtaret e kuvendit që ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës dhe kjo çështje të përfundohet.

**Fatime Haziri, anëtar e kuvendit** –e përkrahi propozim-vendimin për ndërtimin e çashmes publike që të futet në rend të ditës dhe shtoi se kjo çështje duhet të përfundohet pasi që donatori ka shpreh gatishmëri për dhurimin e këtij donacioni.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** –në emër të grupit kuvendar të PDK-së kërkoi që propozim-vendimi për rishikimin e buxhetit të futet në rend të ditës pasi që kjo çështje nuk paraqet shkelje ligjore gjithashtu përkrahi propozim-vendimin për ndërtimin e çashmes publike në vendi ku eshtë propozuar nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Kadastrit.

**Shpëtim Zhegrovë, kryesues i kuvendit** –propozoi që propozim-vendimi për rishikimin e buxhetit të futet si pikë e dytë e rendit të ditës pasi që ky dokument eshtë me urgjencë që të përgatitet vendimi për dërgim në ministrin gjegjëse.

*Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për” tjerat “abstenim” aprovoi këtë:*

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për rishikimin e Buxhetit të Komunës për Vitin 2016;
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i Draft-Planit të veprimit kundër korruptionit i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2019;
5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarje të mirënjojjeve dhe dekoratave për ndër të 17 qershorit Ditës së Çlirimit të Qytetit të Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për anulimin e vendimit 01 nr. 92/15, dt. 30.04.2015;
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;
8. Shqyrtimi i informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë dhe
9. Të ndryshme;
  - a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e panelit përzgjedhës për anëtarësim në Komitetet Konsultative.
  - b). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit përi shpalljen e konkursit për anëtarësim në Komitetet Konsultative.
  - c). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Amra Brahimin;
  - ç). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndërtimin e çeshmës publike;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.*

2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për rishikimin e Buxhetit të Komunës për Vitin 2016;

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se koha ka qenë shumë e shkurtër dhe si anëtarë të kuvendit nuk kanë pasur mundësi që të trajtojnë rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2016. Tutej shtoi se me këtë rishikim duhet ti jepet prioritet interesave të qytetarëve në mënyrë të barabartë dhe jo disa lokaliteteve tu jepet përparësi e disa të mbresin pa asnjë projekt. Mandej ai në këtë kuadër përsëriti qëndrimin e tij për një kërkësë të lagjeve: Ferizi, Peci dhe Hajdari të fshatit Kollë që lidhen me lagjen Islami ku në këtë rast ky projekt ka mbetur në gjysmë. Në këtë kontekst vlerësoi që lidhur me këtë problematikë është mirë që organet komunale të dalin dhe ta vlerësojnë gjendjen përfatim se atje një pjesë e rrugës është përgatitur një pjesë tjetër rrëth 400 m është asfaltuar kurse një pjesë tjetër rrëth 1000 m ka mbetur si rrugë gati e pakalueshme. Lidhur me këtë rrugë ai i adresoj kërkësat e këtyre banorëve që përfatim këtë rrugë të bëhet riparimi si rrugë e rendit të IV. Në vazhdim ai kërkoi që kërkesa në fjalë të analizohet dhe të bëhet e mundur realizimi i saj në kuadër të rishikimit të buxhetit për vitin 2016. Tutej duke vlerësuar procedurat e rishikimit të buxhetit tha se kjo çështje është shndërruar në çështje administrative ku një drejtor apo referent merret me këtë punë dhe kështu kuvendi privohet nga e drejta legitime përfundimisht tu marrë me këtë çështje.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-duke paraqitur sqarime para anëtarëve të kuvendit lidhur me politikat e qeverisjes komunale ceku se me këtë rishikim të buxhetit realisht ka pasur shumë pak mjete financiare të cilat do të rishikohen dhe bartën në projektet tjera dhe përfatim këtë ekzistojnë dy shkaqe kryesore njëri është sa kanë kaluar vetëm 4 muaj kur është shikuar mundësia përfundimisht rishikimin e buxhetit (e që nënkuption se kemi pasur pak aktivitet të prokurimit shpallje të një numri të vogël të tenderëve) dhe në këtë rast kemi më pak se 20,000.00 € të planifikuar që duhet të rishikohen dhe se këto mjete janë propozuar që të destinohen kryesisht në projektet në Drejtorin e Arsimit ku kemi identifikuar se ka nevojë të investohet përfatim se në shkollën e fshatit Smrekonicë kemi mjaft shumë probleme me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, me ç' rast kompania "Unitetit" ka bërë një intervenim të përkohshëm që ka të bëjë kryesisht përfundimisht por jo edhe përfundimisht kanalizimit. Pastaj ai bëri të ditur se në vitin e kaluar kur është aprovuar buxheti i komunës për vitin 2016 janë planifikuar shumë projekte (sidomos që kanë të bëjnë me asfaltim të rrugëve) që realisht mjete ka pasur më pakë. Andaj si rezultat i kësaj po thuaj se gati të gjitha projektet që kanë të bëjnë me asfaltimin e rrugëve kanë mbetur në gjysmë dhe përfatim këtë kemi qenë të obliguar që të bëjmë zgjatjen e afatit të këtyre projekteve nga një vjeçare në projektet dy vjeçare andaj në tabelën 4.2 në kuadër të rishikimit të buxhetit janë paraparë të gjitha këto projekte (rrugë) por edhe projektet tjera nga fusha e Shërbimeve Publike të cilave do t'i zgjatet periudha dhe do të bëhen si projektet dy vjeçare. Në këtë kontekst theksoj se fjalë është përfundimisht rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2016 dhe projektet që janë paraparë me të, janë të rëndësisë më të madhe se sa projektet e parapara në kuadër të buxhetit atëherë pse këto projekte nuk janë aprovuar në kohën kur është

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit**-tha se kur bëhet fjalë përfundimisht rishikimin e buxhetit për vitin 2016 dhe projektet që janë paraparë me të, janë të rëndësisë më të madhe se sa projektet e parapara në kuadër të buxhetit atëherë pse këto projekte nuk janë aprovuar në kohën kur është

aprovar buxhetit i komunës. Pastaj në kuadër të këtij rishikimi flitet për disa rrugë në fshatin Sllatinë, dhe përsërit se rruga kryesore në këtë fshatë është mjaft e dëmtuar dhe duke ju referuar drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm ku ai kishte deklaruar se komuna e ka paditur projektuesin e kësaj rruge dhe ka fituar kontestin në vlerë prej 70,000.00 € andaj me këtë rast pyeti se këto mjete a janë zotuar për këtë rrugë. Në rastin e fshatit Sllatinë pyeti se për cilat rrugë anësore janë paraparë këto mjete. Në fund e përkrahi idenë për ndërtimin e çeshmes publike.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-duke ju referua pyetjes së anëtarit të kuvendit z. Hysni Gërguri se përse nuk është bërë me kohë planifikimi i projekteve me qëllim që tani mos me pas nevojë që këto projekte të bëhen dy vjeçare dhe për këtë ai tha se deri tani gati asnjë projekt nuk e kemi pasur të gatshëm para se të bëhet planifikimi i buxhetit dhe se më herët kur punët janë kryer në saje të para masave ka qenë më e lehtë port tani kur bëhet hartimi i projekteve jemi të obliguar që tenderi të shpallet konform atij projekt. Në këtë relacion ai vlerësoi që për të ardhmen duhet që të gjitha projektet të hartohen para se të bëhet planifikimi i buxhetit dhe aprovimi i tij në kuvend. Mandje lidhur me ekzekutimin e mjeteve financiare nga operatori ekonomik në lidhje me rrugën e fshatit Sllatinë njoftoi se ato mjete akoma nuk janë derdhur në xhirologarinë e komunës dhe ceku se ato mjete nuk mund të dedikohen për ndonjë projekt tjetër për pos ndërtimit të rrugës në fshatin Sllatinë.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së**-paraqiti sqarime profesionale lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2016 duke elaboruar projektet e parapara në kuadër të rishikimit dhe bartjen mjeteve financiare.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha se kur bëhet fjalë për rrugët e rendit të IV por edhe për vendimin për hapjen e trasesë në disa fshatra atëherë Drejtoria e Shërbimeve Publike do të marrë për bazë që këto rrugë ti trajtoj e që kjo do të mund të bëhej edhe në saje të linjës buxhetore ku ka mjete por edhe në bazë të ridestinimit gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**-tha se misioni i qeverisjes së tij ka qenë që duke bërë asfaltimin e rrugëve por edhe shtrimin me kubëza qytetarët tanë të dalin nga “rrugët me balt”. Kurse kjo kërkesa modeste për shtrimin e rrugëve të rendit të IV na bie deri tek pozicion që bëhet gjithë çka që të gjenden mjete për ndërtimin e këtyre rrugëve.

**Agron Perçuku, anëtar i kuvendit** –tha se me qenë se propozimet e grupit kuvendar të LDK-së nuk kanë hyrë as në buxhet por as tash me rishikimin e buxhetit grapi kuvendar i LDK-së është kundër këtij propozim-vendimi dhe për këtë ceku disa arsyet ku rruga në fshatin Dobërrllukë rr. “Xhaferi” e cila ekziston në letra kurse nga organet komunale matjet janë bërë për rrugën ku banon një militant partiak rr. “Sylejman Xhaferi” kurse rruga kryesore e këtij fshati do të futet në projekt “nëse do të ketë marrëveshje për të marrë votat” nga partia në pushtet andaj për këtë dhe arsyet tjera ata janë kundër këtij propozim-vendimi.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –pas rekapitullimit të debatit lidhur me rishikimin e buxhetit të komunës për vitin 2016 konstatoj me sa vijon: e hudhi në votim propozim vendimin për rishikimin e buxhetit të sponzoruar nga Drejtoria e Financave duke përfshirë propozimin e kryetarit të komunës për zgjatjen e afatit të projekteve nga projektet një vjeçare në projekte dy vjeçare konform tabelës 4.2 të propozim-vendimit për rishikimin e buxhetit për vitin 2016 në vlerë financiare prej: 368,923.00 €, si dhe me rekondimin që Drejtoria e Shërbimeve Publike të marrë obligimin për trajtimin e rrugëve të rendit të IV.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, 9 “kundër” tjerat abstenim vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim bëhet rishikimi i mjeteve të buxhetit të Komunës për vitin 2016,në bazë të Instruksionin për Rishikim të Buxhetit për vitin 2016.**

**2.Mjetet buxhetore të rishikuara do të merren nga kategoria e investimeve kapitale nga projektet si në vijim:**

2.1 Ndërtimi i parqeve kodi 43901, shuma.....	15,000.00 €
2.2 Shpronësimet kodi 90237, shuma.....	30,000.00 €
2.3 Punimi i numrave të shtëpive 90250, shuma.....	10,200.0028 €
2.4 Asfaltimi i rrugëve në Shtitaricë-Lagjja Meholl kodi 43914, shuma....	7,915.28 €
<b>Totali.....</b>	<b>63,115.28€</b>

3. Mjetet buxhetore të cekura në pikën 2 të këtij vendimi do të shpërndahen në këto projekte:

3.1 Furnizimi me gypa të ujërave të zeza kodi 41410 shuma .....	15,000.00 €
3.2 Asfaltimi i rrugëve në Stroc kodi 43933 shuma .....	15,000.00 €
3.3 Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra kodi 41424 shuma.....	5000.00 €
3.4. Rrugët e rendit të IV Lagjja Igrishta kodi 90226 shuma .....	10,000.00 €
3.5.Rregullimi i ujësjellësit dhe kanalizimit sh.f Smrekonicë shuma.....	4,500.00 €
3.6 Renovimi i shkollës filllore në Beçiq shuma .....	3,415.28 €
3.7 Rregullimi i murit mbrojtës dhe rrrethojës së shkollës filllore Oshlan shuma.....	4000.00 €
3.8 Rregullimi i rrrethojave në sh.f. Pestovë dhe Zhilivodë shuma .....	6,200.00 €
<b>Totali.....</b>	<b>63,115.28 €</b>

4.Me rishikimin e buxhetit për vitin 2016 bëhet zgjatja e afatit të projekteve nga periudha një vjeçare në periudhë dy vjeçare (2016-2017) në projektet si në vijim:

4.1 Rregullimi i lumit “Terstena” kodi 43892 shuma.....	42,913.00 €
4.2 Ndërtimi i trotuarit në Smrekonicë kodi 43894 shuma.....	25,000.00 €
4.3 Ndërtimi i varrezave të Dëshmoreve kodi 43898 shuma.....	34,600.00 €
4.4 Asfaltimi i rrugëve në Bukosh (lagjia Osmani,Dushi,Mehmeti,Hajrizi) kodi 43925 shuma .....	75,600.00 €
4.5 Asfaltimi i rrugëve në Dumnic lagjia Abazi kodi 43930 shuma .....	22,340.00 €
4.6.Asfaltimi i rrugëve Doberlluk (lagjia Xhaferi-Merovci) kodi 43932 shuma.....	35,000.00 €
4.7.Asfaltimi i rrugëve në Konovik (lagjia Parduzi-Muli) kodi 43934 shuma.....	105,470.00 €
4.8.Asfaltimi i rrugëve lokale në Ashlan (lagjia Selatin Hyseni) kodi 43934 shuma.....	28,000.00 €
<b>Totali.....</b>	<b>368,923.00 €</b>

5. Mjetet e ri destiguara në kuadër të rishikimit të buxhetit komunal për vitin 2016 do të barten sipas tabelës standarde 4.1 dhe 4.2, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

6.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3.Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë;

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit-propozoi që tek neni 3 të shtohet edhe një paragraf ku do të përcaktohesin mënyrat e përfundimit të mandatit të kryesuesve dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon në mënyrat si në vijim: me kryerje të mandatit, me vdekje, me dorëheqje, nëse e ndërron vendbanimin dhe nëse shkarkohet. Mandaj tek neni 7 i draft rregullores paragrafi 1**

pika a duhet propozoi që të ndryshohet fjalia “brenda territorit të komunës” dhe të bëhet në territorin e fshatit-vendbanimit kjo me qëllim të informimit sa më të mirë të qytetarëve.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-përsëriti** qëndrimin e saj që kryetaret e këshillave të fshatrave dhe anëtaret të kompensohen me qëllim të rritjes së efektivitetit të këtyre këshillave në të kundërtën puna e tyre do të jetë më tepër formale. Në fund tha se procedura për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave duhet të rregullohet me një nenë të veçantë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

**1.Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Vushtrrisë.**

**2.Diskutimi publik fillon nga data 01 qershor 2016 dhe zgjatë deri më 15 qershor 2016.**

**3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

**4.Obligohet Drejtoria për Administratë (DA-ja) që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

Gjithashtu Drejtoria e Administratës obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin qershor 2016.

**4.Shqyrtimi i Draft-Planit të veprimit kundër korruptionit i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2019;**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

**1. Jepet në diskutim publik Draft-Plani i veprimit kundër korruptionit i Komunës së Vushtrrisë.**

**2. Diskutimi publik fillon nga data 1 qershor 2016 dhe zgjatë deri më 15 qershor 2016.**

**3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

**4. Obligohet Grupi Punues që si hartues dhe propozues i Draft-Planit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.**

Gjithashtu Grupi Punues obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin qershor 2016.

5.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarje të mirënjohjeve dhe dekoratave për nder të 17 qershorit Ditës së Çlirimtës së Qytetit të Vushtrrisë;

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit-propozoi** që lidhur me çështjen e ndarjes së mirënjohjeve të formohet një komision nga ana e kuvendit dhe propozoi që për këtë temë të merret një pauzë për konsultim.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit-** propozoi Ramadan Gjonin për mirënjohje për kontributin e tij si mjek si (pediatër i njohur) pastaj për kontributin e tij në shoqatën “Nëna Terzë” si dhe njëkohësisht për kontributet e tij si anëtarë i drejtorisë paralele në shëndetësinë komunale.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-** propozoi Naxhije Maloku, për mirënjohje për kontributin të dalluar në ofrimin e ndihmës (strehimit) për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë para dhe gjatë luftës së fundit.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-propozoi** për mirënjohje Nezir Klinaku, për kontribut të çmuar për çlirimin e Kosovës, veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Brigadën 142 të Zonës Operative të Shalës.

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit-** propozoi për mirënjohje Sabri Behrami, (post mortum) veteran i UÇK-së si dhe punëtor i dalluar në administratën komunale.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha** se pare se të jepeshin propozimet individuale për mirënjohje do të ishte mire që të votohej për formimin e komisionit për mirënjohje kurse për ndarje të mirënjohjes propozoi Idriz Muzaqin, për kontributin e tij profesional si zyrtar ligjor si dhe përfaqësim dinjitoz të interesave të Komunës së Vushtrrisë.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit-** propozoi për mirënjohje Agim Bregajn, për kontributin e tij në lëmin e shëndetësisë dhënë Batalionit IV të Brigadës 141 “Mehë Uka”.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-propozoi** Bahrije Pllanen, për mirënjohje për kontributin e dhënë në fushën e arsimit, aktiviste dhe mësimdhënëse e dalluar.

**Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-** propozoi për mirënjohje Ismet Shaqirin, për kontributin e dhënë në lëmin e shëndetësisë në Brigadën 141 “Mehë Uka”.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-** propozoi për mirënjohje sportistin e njohur Vushtrrias Aremnd Dallku i cili ka mbrojtur ngjyrat e kombëtares shqiptare në futboll.

*Në vazhdim kuvendi me 22 vota “për” të tjerat abstenim formoi komisionin për ndarjen e mirënjohjeve në këtë përbërje:*

Isa Hajrizi, PDK

Melihate Basholli, PDK

Fatime Haziri, LDK

Mehmet Selaci, LVV

Mirjeta Salihu, AKR

*Në vijim Komisioni për Ndarjen e Mirënjohjeve u tërhiq në mbledhje të myllur duke u marr me organizimin dhe seleksionimin e propozimeve për mirënjohje kurse kuvendi i komunës vazhdoj punimet e tij duke shqyrtuar pikë tjetra të radhës të rendit të ditës:*

6.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 nr. 92/15, dt. 30.04.2015;

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanim vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01 nr. 92/15 të datës 30.04.2015 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të**

Komunës, pjesë nga parcela kadastrale nr. 190, fletë treguesi nr. 204 në sipërfaqe prej  $900m^2$ , nga sipërfaqja e përgjithshme prej  $2571m^2$ , Zona Kadastrale-Studime e Poshtme, e evidentuar në emër të PS Komisioni për Komosacion.

2. Shfuqizimi i vendimit i cekur në pikën “1” bëhet për arsyet e Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës të dhënë në shfrytëzim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendi të ditës, duke shtuar se afati për dhënien në shfrytëzim duhet të jetë 10 vjet ashtu qyshështë propozuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa kurse çmimi fillestarë propozoi të jetë 800 € në muaj, si dhe duhet të specifikohet që në kuadër të këtij vendimi jepet në shfrytëzim objekti prej  $90m^2$  dhe oborri që eshtë pjesë përbërëse e kësaj prone komunale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në këto lokacione:

1.1 Lokacioni, i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr. P-70202016-0000127-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës, e cila përfshinë një sipërfaqe oborr  $187m^2$  si dhe shtëpi prej  $157m^2$ . Nga sipërfaqja e shtëpisë prej  $187m^2$  jepen në shfrytëzim vetëm  $0.90m^2$ , i cili gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit”

2. Prona e cekur në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik personave fizik dhe juridik në kohëzgjatje prej 10 viteve.

2.1 Çmimi fillestarështë 800€ në muaj.

2.2 Të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me lokalini bartë përfituesi i ankandit.

2.3 Komuna rezervon të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës, nëse një gjë të tillë e parashevë interesin e përgjithshëm. Në këtë rast, Komuna duhet ta njoftojë shfrytëzuesin e objektit së paku 30 ditë para ndërpërjes së kontratës.

3. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave, pas lidhjes së tyre.

8. Shqyrtimi i informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar informatës në fjalë tha se rrëth 13.218 hektar me pyje sa posedon komuna jonë ruajtja e tyre me vetëm 4 rojtarështë jo serioze dhe këtu në këtë rrafsh shtronhen shumë dilema për shkatërrimin e normës të pyjeve. Në fund tha se mbulimi i tërë kësaj sipërfaqe pyjore me vetëm 4 rojtarështë qesharake dhe absurdë

dhe se kjo sigurisht se do të ketë konsekuenca të rënda në çështjet ambientale dhe në mbrojtjen e pyjeve në komunën tonë.

**Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-tha** se jemi dëshmitar të mbrojtjes jo adekuatë të pyjeve dhe shkatërrimit të tyre, dhe shtoi se kjo informatë është dashur të jetë më e detajuar me të dhëna të tjera sa i përket prerjes dhe ripyllëzimit. Tutej ceku se përpos shkatërrimit të pyjeve nga faktori njeri ato po shkatërrohen edhe nga insektet për shkak të mos spërkatjes për këtë çështje apeloi që ndërmerr masa qoftë nga niveli qendror apo edhe ai lokal.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-tha** se tek plani i pyllëzimeve kemi shifrën zero dhe pyeti se përse komuna nuk ndërmerr asgjë lidhur me këtë proces, kur dihet se çfarë interesit kemi nga ripyllëzimet.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha** se në Komitetin për Politikë dhe Financa është kërkuar që kjo informatë të plotësohet edhe me të dhëna tjera për shembull se sa hektar me pyje janë të dëmtuara në komunën tonë, pastaj se cilat janë masat që janë ndërmarr për mbrojtjen e pyjeve në komunë tonë si dhe shprehu dilemën e saj lidhur me pikën 6 dhe 7 të kësaj informate për shkak të paqartësive.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha** se kjo informatë është shumë e mangët krahasuar me vitin e kaluar. Tutej shtoi se numri i vogël i rojave të pyllit në komunën tonë është duke na përcjellë edhe këtë vit dhe ceku se nëse e përpjesëtojmë sipërfaqen e pyjeve del mesatarja se një roje e pyllit duhet të mbuloj afro 10 hektar të pyjeve (norma mesatare). Lidhur me këtë çështje vlerësoi se duhet të rritet numrit i rojave të pyllit dhe ai duhet të jetë të paktën 10 rojtar të pyllit. Pastaj duke parafrazuar informatën në fjalë tha citojmë: gjatë vitit 2015 kemi bërë mbrojtjen dhe kontrollimin permanent të pyjeve në aspektin e prerjeve legale, ilegale dhe uzurpimeve lidhur me këtë ceku se si ka mundur të bëhet një kontroll i tillë kur kemi mungesë kaq të madhe të rojtarëve të pyjeve.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-shprehu** indinjatën e tij lidhur me mos prezencën e Drejtoreshës për Ekonomi në mbledhjen e kuvendit dhe ceku se kjo është fyerje që po iu bëhet anëtarëve të kuvendit.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-tha** se ajri, uji toka dhe biodiversitetit janë katër përbërësit kryesor të mjedisit andaj komponenti kryesor i cili mund të ruaj por edhe ti dëmtojë përbërësit kryesorë të mjedisit janë pyjet. Duke marrë për bazë rendësin kaq të madhe të pyjeve mendon se nuk po bëhet sa duhet për mbrojtjen e tyre.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit-tha** se pyjet e komunës sonë nuk janë vetëm të një individi dhe ceku se të gjithë duhet të angazhohemi në gjetjen e metodave për mbrojtjen e tyre.

9.Të ndryshme;

a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e panelit përzgjedhës për anëtarësim në Komitetet Konsultative.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 1.5 e Vendimit 01 Nr.57/16 i datës 31.03.2016 për Formimin e Panelit Përzgjedhës për Anëtarësim në Komitetet Konsultative, ashtu që në vend të Isak Hysenit nga shoqëria civile zgjidhet Blerim Ibrahimini.**

**2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.**

b).Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ri shpalljen e konkursit për anëtarësim në Komitetet Konsultative;

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –tha pasi nuk kemi pasur kandidat të mjaftueshëm për anëtarësim në komitetet konsultative ligjërisht jemi të obliguar të marrim vendimi për rishpaalljen e këtij konkursi në afat prej 15 ditësh kurse kandidatet të cilët kanë aplikuar më herët nuk do kenë nevojë të aplikojnë serish pasi që dokumentet e tyre janë të vlefshme.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim rishpallet konkursi për anëtarësim në këto Komitete Konsultative të KK-së:**

- 1.1 Komiteti për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini (7 anëtarë);
- 1.2 Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (7 anëtarë);
- 1.3 Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit (7 anëtarë);
- 1.4 Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (7 anëtarë);
- 1.5 Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (7 anëtarë);
- 1.6 Komiteti për Personat me nevoja të Veçanta (7 anëtarë).

**2.Kushtet e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenet 4.1, 4.3 dhe 4.4 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/10.**

**3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.**

c). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për Amra Brahimin;

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej pesëqind euro (500 €) nga buxheti i komunës – fondi për subvencione për Amra Brahimini me banim në Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë.**

**2.Shuma e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi ndahet me qëllim të shërimit të sëmundjes së saj dhe do të barten në xhirologarinë e nënës së saj Merita Brahimini.**

**3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

ç). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndërtimin e çeshmës publike;

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –propozoi që kjo çeshme publike të vendoset tek shkolla e mesme teknike dhe arsyetoj se ky lokacion është adekuat dhe nuk pengon qarkullimin e automjeteve dhe të nxënësve e njëjtë afër parkut dhe ju shërben qytetarëve për çlodhje. **Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** –tha se është më rëndësi të gjendet lokacioni i përshtatshëm më vendosjen e kësaj çeshme publike dhe ceku se do të ishte mirë që kjo të vendosej në ndonjë vend frekuentuese d.m.th në qendër të qytetit.

**Arta Ismajli, anëtar e kuvendit**–tha se tek pika e 3 e propozim-vendimit në fjalë duhet të ndryshohet fjala “anulohet” dhe në vendi të saj duhet të bëhet –shfuqizohet vendimi Nr.147/14

i datës 26.06.2014 për ndërtimin e çashmes publike në sheshin “Adem Jashari”. Pastaj lidhur me lokacionin për vendosjen e çashmes ceku se është e pajtimit që ky objekt të vendoset tek shkolla teknike.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit-tha** se lokacioni më i përshtatshëm për vendosjen e kësaj çeshme publike është tek shkolla teknike, për faktin se edhe nxënësit furnizohen me ujë.

**Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-tha** se kjo çeshme publike do të ishte mirë që të vendosej në qendër të qytetit, kurse për lokacionin tek shkolla teknike tha se atje ka nxënës shumë ekziston mundësia që ky objekt të dëmtohet nga nxënësit. Andaj ceku se lokacioni më i mirë është që kjo çeshme të vendoset tek “Hamami i Qytetit” pasi që edhe struktura e objekteve që ndodhen atu i përshtatet vendosjes së këtij objekti.

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-paraqiti** sqarime profesionale lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke cekur se lokacioni tek shkolla teknike është pronë e shkollës dhe është vend i përshtatshëm për vendosjen e kësaj çeshme.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 17 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërtimi i çeshmës publike në rrugën “Dëshmoret e Kombit” përballë objektit të shkollës teknike në parcelën kadastrale P-702020016-01116-0 pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Mjetet financiare për ndërtimin e çeshmës publike të përmendura në pikën “1” të vendimit i bart qytetari (në cilësinë e donatorit) nga Ankaraja e Turqisë Mustafa Genç.
3. Me këtë vendimit bëhet shfuqizimi i vendimit nr. 147/14 të datës 26.06.2014 për ndërtimin e çeshmës publike në sheshin “Adem Jashari”.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: fleta poseduese dhe kopja e planit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

*Pas shqyrtimit të gjitha pikave të rendit të ditës, anëtaret e kuvendit filluan procesin e votimit të fshehtë lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës : Propozim-Vendimin për ndarje të mirënjohjeve dhe dekoratave për nder të 17 qershorit Ditës së Çlirimit të Qytetit të Vushtrrisë;*

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – kërkoi që numërimi i votave për kandidatët për mirënjohje të bëhet publikisht para anëtarëve të kuvendit.

*Pas përfundimit të votimit të fshehtë të propozuarve për mirënjohje rezultojë se kandidatët për mirënjohje Abaz Shyti dhe Ramadan Gjoni morën secili nga dhjetë (10) vota, me ç' rast kuvendi ishte i obliguar të zhvilloj edhe një rund të votimit mes dy kandidatëve të cekur.*

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – kërkoi që të dy kandidatët të cilët morën vota të barabarta të marrin mirënjohje.

**Albanez Tahiraj, zyrtar ligjor-paraqiti** sqarime profesionale, duke njoftuar anëtaret e kuvendit se Rregullorja për Dekorata është në procedurë të ndryshimit andaj me rregulloren në fuqi për një datë të shënuar nuk mund të ndahen më tepër se dhjetë (10) mirënjohje. Në fund tha se nëse mendohet të shmanget rregulloja duhet të procedohet ndryshimi i saj.

Në fund të procesit të votimit lidhur me Propozim-Vendimin për ndarje të mirënjohjeve dhe dekoratave për nder të 17 qershorit Ditës së Çlirimtës së Vushtrrisë, kuvendi pas votimit të fshehtë vendosi që t’iu ndajë mirënjohje këtyre kandidatëve :

1. Me këtë Vendim, për nder të Ditës së Çlirimtës së Vushtrrisë, me 17 qershor 2016 nderohen me mirënjohje:

- 1.1 SHMU-1 Fituese në kuizin: “Champion kuiz”, i cili u organizua në nivel republike;
- 1.2 Dr. Ahmet Ademi, kardiolog i dalluar, ka shërbyer vullnetarisht ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
- 1.3 Ramadan Gjoni, për kontribut në fushën e shëndetësisë “Pediatër i dalluar ” si dhe për aktivitetin e tij në shoqatën “Nënë Tereza”;
- 1.4 Naxhije Maloku, për kontribut të dalluar në ofrimin e ndihmës (strehimit) për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë para dhe gjatë luftës së fundit.
- 1.5 Nezir Klinaku, për kontribut të çmuar për çlirimin e Kosovës, veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Brigadën 142 të Zonës Operative të Shalës.
- 1.6 Sabri Behrami, (post mortum) veteran i UÇK-së si dhe punëtor i dalluar në administratën komunale.
- 1.7 Idriz Muzaqi, për kontributin e tij profesional si zyrtar ligjor si dhe për përfaqësim dinjitoz të interesave të Komunës së Vushtrrisë.
- 1.8 Agim Bregaj, për kontributin e tij në lëmin e shëndetësisë dhënë Batalionit IV të Brigadës 141 “Mehë Uka”;
- 1.9 Bahrije Pllana, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit, aktiviste dhe mësimdhënëse e dalluar;
- 1.10 Ismet Shaqiri, për kontributin e dhënë në lëmin e shëndetësisë në Brigadën 141 “Mehë Uka”.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

*Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi për ndarjen e çmimit ‘Qytetar Nderi’ dhe çmimin ‘Nderi i Qytetit’ për këto personalitete:*

1. Me këtë Vendim, Muharem (Rakip) Amati nga Shkupi – Maqedoni, Zekrija (Shaban) Islami, Sefer (Tahir) Imishti, dhe Osman (Kamer) Islami nga Blaca-Maqedoni shpalen “QYTETARË NDERI” të Komunës së Vushtrrisë, për kontributin e tyre për çështjen kombëtare në luftën e fundit çlirimtare, ku kanë shërbyer në Brigadën 142 të Zonës Operative të Shalës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës me datën 17 qershor Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë.**

**3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**1. Me këtë Vendim Hajzer Krasniqit nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi “Nderi i Qytetit”, për kontributin e dhënë si Mësimdhënës i gjuhës shqipe; i diferencuar i pushtetit komunist sepse kundërshtonte atë sistem; aktivist i çështjes kombëtare gjatë viteve 90-ta të shekullit XX; një kohë pas çlirimit Kryetar i Komunës së Vushtrrisë; personalitet i urtë, i vendosur, i kujdeshëm.**

**2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës me datën 17 qershor Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë.**

**3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

*d). Pyetet e anëtarëve të kuvendit.*

**Arta Ismajli, anëtar e kuvendit-pyeti Drejtorinë e Arsimit lidhur me një sulm fizik ndaj një mësimdhënëse në fshatin Stanoc i Poshtëm kërkoi të informohet se përse Drejtoria e Arsimit nuk ka bërë asnje reagim zyrtar lidhur me atë se a është ndërmarrë ndonjë veprim i caktuar lidhur me këtë rast.**

**Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-duke ju adresuar Drejtorisë së Arsimit pjeti lidhur me heqjen e bustit të heroit kombëtar Azem Galica në shkollën e fshatit Duboc ku kërkoi të informohet se Drejtoria e Arsimit çfarë masash ka ndërmarrë lidhur me këtë rast dhe se a ka ndonjë informacion nga policia se përse nga kush dhe për çfarë arsyet u hiq ky bust nga ai vend.**

**Adnan Klinaku, anëtar i kuvendit-në emër të Partisë së Drejtësisë dega në Vushtrri të gjithë besimtarëve të besimit Islam iu uroj muajin e madhërishëm të ramazanit.**

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-pyeti se lidhur me atë se javë më parë një delegacion nga komuna jonë ka vizituar Komunën e Mamakut –Turqi, por thuhet se delegacioni i komunës sonë ka shkuar edhe për pushime në Antali dhe me këtë rast kërkoi që kjo çështje të sqarohet pasi që a bëhet fjälë vetëm për vizitë zyrtare apo edhe për ndonjë vizitë tjetër.**

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –duke ju referua një pike të rendit të ditës nga mbledhja e kaluar e kuvendit që kishte të bënte me dhënien në shfrytëzim të një prone për ndërtimin e fabrikës për riciklimin e mbeturinave ceku se lidhur me këtë çështje me qëllimin më të mirë që mos të bllokohej ky projekt kishin kërkuar interpretimin ligjor të Zyrës Ligjore të Komunës por edhe në Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në saje të kësaj kemi marrë interpretimin që kjo çështje është në kundërshtim me ligjin. Tulle shtoi se në mbledhjen e kaluar të kuvendit në mbledhje kishte qenë prezent një përfaqësues i një OJQ-je përmes së cilës komuna ka fituar këtë projekt në Komisionin Evropian dhe nga mbledhja e kaluar e kuvendit përfaqësuesi i asaj OJQ-je ka dal me një reagim ku i ka fyer të gjithë anëtarët e kuvendit duke shprehur një mesazh ne faqen e tij në facebook duke thënë se: “është turp se kush i përfaqëson qytetarët e Komunës së Vushtrrisë” Pastaj ai vazhdoi duke sqaruar se pas kësaj ai si kryesues i kuvendit i kishte thirrur përfaqësuesit e partive politike të përfaqësuara në kuvend për ta bërë një reagim kundër këtij shkrimi me çka ishin marrë vesh q reagimi të bëhej në kuvend. Mandjej në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa anëtarët e këtij komiteti kanë reaguar por e keqja qëndron se Drejtoresha e Drejtorisë për Ekonomi Arta Haxhaj e ka mbështetur shkrimin e përfaqësuesit të asaj OJQ-je duke shkuar edhe më lart se pajtohet me atë vlerësim dhe se për

një pjesë të anëtarëve të kuvendit nuk ndjenë kurrfarë respekti. Gjithashtu ai tha se Drejtoresha e Drejtorisë për Ekonomi duhet të kërkoj falej publike ndaj anëtarëve të kuvendit në të kundërt ai si kryesues i kuvendit nuk do të votoj asnjë pikë të rendit të ditës që procedohet nga Drejtoria për Ekonomi. Lidhur me kompaninë e cila është e involvuar në këtë projekt ceku se ajo e ka interesin e vetë që është krejt legitime sepse ka aplikuar dhe ka fituar projektin por e keqja qëndron në shpenzime manipulative që i kanë krijuar që prej një projekti prej 470,000.00 €, 170,000.00 € i kanë destinuar për investime kapitale kurse 300.000.00 € janë destinuar për shpenzime manipulative ky projekt ka kaluar përmes Komisionit Evropian dhe kuvendit nuk ka kurrfarë të drejte në këtë drejtim. Mandej ai sqaroj se kuvendi i komunës nuk ka të drejtë të jep pronë shfrytëzim për cilindro subjekt pa e përfill procedurën e ankandit publik dhe rregullat e konkurrencës. Në marrëveshjen e lidhur mes organizatës në fjalë dhe Komisionit Evropian thuhet se komuna duhet të formoj ndërmarrje sociale por ne akoma nuk kemi një ligj të tillë. Pastaj duke ju referuar vendimit të kuvendit me të cilin është themeluar partneritetit me Komisionin Evropian dhe është investuar në atë fabrikë dhe marrëveshja për këtë projekt është nënshkruar andaj nuk ka ma nevojë që kuvendi të merr serish vendimi për këtë çështje. Në vazhdim duke ju referuar konfliktit të interesit ceku se Drejtoresha e Drejtorisë për Ekonomi paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe në të njëjtën kohë është edhe menaxhere në atë OJQ, dhe kjo është shkelje ligjore.

**Tasim Gubetini, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar diskutimit të kryesuesit të kuvendit vlerësoi se ai ceku disa gabime por tani bëri vetë një gabim kur tha se nuk do të votoj asnjë pikë që ofrohet nga Drejtoria e Ekonomisë për faktin se nuk këtë rrafsh nuk bëhet fjalë vetëm për një individ por për drejtorin në tërësi. Andaj çdo anëtar i kuvendit mund të votoj ashtu si e vlerëson vetë por jo të bëjë agitacion politik kundër subjekteve të caktuara.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit**-tha se edhe herën e kaluar ka shprehur dyshimet e tij se në atë projekt ka keqpërdorime për faktin se një projekt i cili merret në emër të komunës dhe komuna mos me qenë garantues atëherë kjo çështje lenë vend për dyshime. Mandej shtoi se praktika që donacionet ndërkombëtare që merren në emër të autoritatave publike dhe kthen në pronë privat është bërë e zakonshme. Në fund ai kërkoi që organet e drejtësisë të merren me këtë rast dhe ta ndriçojnë deri në fund se a ka pasur keqpërdorime apo jo.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se në këtë kontekst duhet të sqarohet një pozicion për faktin se drejtoresha e Drejtorisë për Ekonomi është në konflikt të interesit dhe kjo saktësohet edhe me nenin 63 të LVQL. Andaj lidhur me këtë çështje kërkoi interpretim ligjor nga zyra ligjore e komunës për faktin se drejtoresha e sipër cekur merr pagë nga komuna por edhe nga ky projekt i cili është në bashkëfinancim me komunën.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit**- në emër të grupit kuvendar të LDK-së tha se e kundërshton fuqishëm vlerësimin e përfaqësuesit të OJQ-së RE-ja që ka bërë në adresë të anëtarëve të kuvendit kurse lidhur me çështjen kontestuese të pronës e cila duhet ti jepet fabrikës duhet të pritet opinioni i Ministrisë së Pushtetit Lokal.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** –tha se drejtoresha e Drejtorisë për Ekonomi duhet të kërkoj falje për faktin se të gjithë mund të gabojnë por nëse nuk kërkohet falje atëherë rrëzikohet bashkëpunimi mes kuvendit dhe drejtorisë në fjalë.

**Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së**-duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit ceku se rasti i incidentit në shkollën filllore të fshatit Stanoc i Poshtëm është për keqardhje për fakti se një nxënës të cilin e edukon për tetë vite rresht ta sulmoj mësimdhënësin është një gjë shumë e pahijshme. Tutje shtoi se për rastin konkret ligjërisht nuk janë të thirrur të ndërmarrin masa represive por masa tjera edukative që bëjnë të mundur trajtimin adekuat të atij nxënësi. Mandej në pyetje lidhur me heqje e bustit të “Azem Bejtës” në shkollën e fshatit Duboc tha se ky rast ka ndodhur në kohën kur komuna ka bërë mjaft shumë investime në atë shkollë dhe shtoi se sigurisht se prapa kësaj ngjarje fshihet diçka e që shpreson që organet kompetente do të ndriçojnë këtë rast.

**Melihate Basholli, anëtar e kuvendit-kërkoi** nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit që nxënësve pjesëmarrës në kuiz (gara) ndërkomëtare tu ndahen mirënjoyje nga ana e Drejtorisë së Arsimit.

**Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-duke ju referuar diskutimit të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit** pyeti se kjo drejtori a është konsultuar me organet e rendit lidhur me rastin e heqjes së bustit të "Azem Galicës" në shkollën e fshatit Duboc, dhe se a janë ftuar nga ana e drejtorisë organet e rendit për të bërrë hetim lidhur me këtë rast.

**Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së-tha** se nxënësit të cilët kanë marrë pjesë në gara ndërkomëtare do të shpërblehen konform rregullores për bursa me një mirënjoyje dhe me nga 100 €. Kurse sa i përket rastit të heqjes së bustit drejtori i asaj shkolle menjëherë pasi ka ndodhur kjo ngjarje i ka lajmëruar organet e rendit dhe këto të fundit janë duke u marrë ndriçimin e këtij rasti për më tutej ai shprehu se nuk është kompetent të japë sqarime.


**Arta Ismajli, anëtar e kuvendit-përsëriti** se Drejtoria e Arsimit është duke tentuar ta izoloj rastin e nxënësit në shkollën e fshatit Stanoc i Poshtëm dhe ceku se kjo drejtori minimalisht çka është dashur të bëjë është plasoj të paktën një reagim zyrtar në faqen zyrtare të komunës, për ndryshe izolimi i rasteve të tillë është shtytje për nxënësit tjerë për të aplikuar dhunë ndaj mësimdhënësve të tyre.

**Mbledhja përfundoi në orën 14:50.**


Bastri Duraku



Procesmbajtës



Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit